

VENDIM
Nr. 152, datë 30.6.2021

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË ‘OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR’ ALBGAZ SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2020, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 96/2 prot., datë 23.6.2021, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, ‘Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit natyror’, ‘Albgaz’ sh.a.’, i ndryshuar”

konstatoi se:

- Mbështetur në kushtet e parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, rezulton se shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:

1. Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimit, “Albgaz” sh.a. do t’i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme, që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i “Albgaz” sh.a., Ministria e Ekonomisë, kanë ndodhur dhe janë efektive.

2. Gjithashtu, në mënyrë periodike, shoqëria “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE deklaratat e audituesve financiarë dhe pasqyrat financiare të saj çdo vit ushtrimor.

- Për kushtin që lidhet me bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresat nr. 68 prot., datë 3.3.2020 dhe nr. 176/1 prot., datë 28.10.2020 (përcjellë edhe në ERE), me të cilat i ka bërë prezent formalisht qëndrimin e saj të argumentuar në përmbushje të kushtit të certifikimit. Për sa kohë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke vlerësuar kërkesat e sipërcituara, shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrje të afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 20.12.2021.

Ky kusht mbetet ende pa u plotësuar dhe shoqëria “Albgaz” sh.a. të vazhdojë komunikimet me ministrinë.

- Për sa i përket kushtit që lidhet me paraqitjen në ERE çdo vit ushtrimor të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë, shoqëria “Albgaz” sh.a. sqaron se: “Në zbatim të dispozitave statutores Asambleja e Përgjithshme e “Albgaz” sh.a., përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në kompetencë përcaktimin e audituesit të pavarur financiar, për kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare çdo vit ushtrimor. Duke qenë se shoqëria “Albgaz” sh.a. është aksionare në shoqërinë AGS, si zotëruese e 75% të kapitalit të saj, ka detyrimin ligjor të kryejë bilanc të konsoliduar. Në këto kushte, për sa kohë që AGS-ja është në proces auditimi dhe nuk ka mundur të dorëzojë formalisht pranë “Albgaz” sh.a. bilancin e saj, kjo e fundit bën me dije se është në pritje të

përfundimit të procesit të auditimit të shoqërisë AGS, në mënyrë që të ketë një dokument përfundimtar për ta paraqitur në ERE në kuadër të plotësimit të këtij kushti periodik.”.

Ky kusht mbetet ende pa plotësuar duke qenë se kushtëzohet nga sa më sipër.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citon se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Në konsideratë të sa më sipër, kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës, është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 261, datë 28.12.2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 5.1 dhe pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, si më poshtë:

“5.1 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE, çdo vit ushtrimor, informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

5.2 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE, brenda datës 20.1.2022, provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Financave dhe Ekonomisë.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti